



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE TË
ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË

Nr. 1045 prot.

Tiranë, më 04.02.2025

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr. 1631, datë 19.06.2013.

SHOQËRISË “SUPER BETON MATI” SH.P.K
Rr. “Kuvendi i Dukagjinit”, Zona Kadastrale 1326, Nr.pasurie 7/243 , Burrel, Dibër

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

Shoqëria “SUPER BETON MATI” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1631, datë 19.06.2013, për mineralin gur gëlqeror, në Objektin “Qaf Shkozë”, Bashkia Klos, Qarku Dibër.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 5512, datë 13.12.2024, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 9785 Prot., datë 16.12.2024, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1631, datë 19.06.2013, për mineralin gur gëlqeror, në Objektin “Qaf Shkozë”, Bashkia Klos, Qarku Dibër, pasi në objektin minerar nuk ushtrohet aktivitet prej më shumë se një viti kalendarik.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “c” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr.1631, datë 19.06.2013, për mineralin gur gëlqeror, në Objektin “Qaf Shkozë”, Bashkia Klos, Qarku Dibër, që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1631, datë 19.06.2013, për mineralin gur gëlqeror, në Objektin "Qaf Shkozë", Bashkia Klos, Qarku Dibër, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE
MINISTRI**

**BELINDA BALLUKU
ME URDHËR PËR DELEGIM
ZËVENDËSMINISTRI
CENO KLOSI**

